



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRŽIŠTA A.D

- BULETINI

nr. 14 / Viti X, 2017



PËRMBAJTJA

KOSTT ndër kompanitë e para publike vendore që certifikohet me tri standard ndërkombëtare: ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 si dhe ISO 9001:2015.....	3
Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë zotohen për unifikimin e tregut të energjisë dhe pjesëmarrjen e KOSTT në APEX.....	4
Inaugurohet Asociacioni i Gruas në Sektorin e Energjisë në Kosovë.....	4
Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim zv.Ambasadorin e RF të Gjermanisë Jan Axel Voss dhe delegacionin nga KfW.....	5
Integrimi i Burimeve të Ripërtërishme në Rrjetin Transmetues dhe menaxhimi i Fondit për Energjinë e Ripërtërishme.....	6-7
KOSTT nënshkruan Marrëveshje me Gjeneratorët e Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme.....	7
KOSTT merr pjesë në Seancën Dëgjimore për Shqyrtimin e Dytë Periodik Rregullativ.....	8
Drejtori i Zyrës Rajonale Evropiane të Departmentit të SHBA për Energji vizitoi KOSTT-in.....	9
Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT.....	10
KOSTT nënshkruan marrëveshjen e parë me kompani vendore për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre).....	11
Komiteti Nacional CIGRE Kosova anëtarësohet në Asociacionin Ndërkombëtar CIGRÉ, me seli në Paris	12
KOSTT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit “Hasan Prishtina”	12
Emërtimi i Pajisjeve të Rrjetit Transmetues.....	13
Projekti për Asistencën në Ngritjen e Kapaciteteve të KOSTT-it.....	14

Buletini nr.14, Viti X, 2017

Buletini është publikim i KOSTT sh.a-Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun

Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës


Tel: +381(0) 38 501 301 174; email: info@kostt.com

Web: www.kostt.com


Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:

Zyrën për Komunikim dhe Relacione me Publikun në:

zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com



KOSTT ndër kompanitë e para publike vendore që certifikohet me tri standarde ndërkombëtare: ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 si dhe ISO 9001:2015



Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a, ka pranuar tri certifikata ndërkombëtare nga kompania britaneze QEC-EAS International Control and Certification.

KOSTT u çertifikua për herë të parë me Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 si dhe Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë OHSAS 18001:2007, derisa që nga viti 2010 KOSTT është çertifikuar në mënyrë të vazhdueshme me standardin ndërkombëtar për menaxhim të cilësisë ISO 9001:2008, derisa tani u certifikua me versionin më të ri të këtij standardi ISO 9001:2015.

Me këtë, KOSTT bëhet kompania e parë publike në Kosovë e certifikuar me këto tri standarde ndërkombëtare të cilësisë.

Këto certifikata të vlerësuara globalisht, dëshmojnë përkushtimin e KOSTT për ngritjen e cilësisë së punës dhe ekselencës së biznesit në përputhje me standarde të përcaktuara ndërkombëtare.

Standardi ISO 14001:2015, është standardi më i njohur ndërkombëtar i cili i përcakton kriteret sipas të cilave kompanitë e vendosin sistemin e

menaxhimit mjedisor të veprimtarisë së tyre. Në pajtim me standardin ISO 14001:2015 si dhe në pajtim me legjislacionin vendor, KOSTT aplikon kornizën e kriterëve të përcaktuara për të identifikuar, kontrolluar dhe monitoruar aspektet dhe ndikimet mjedisore të veprimtarisë së vet.

Ndërsa, përmes aplikimit të kriterëve të standardit të njohur ndërkombëtar OHSAS 18001:2007 dhe në pajtim me legjislacionin vendor, KOSTT ka siguruar mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm për të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe vizitorët të cilët përdorin hapësirat dhe pajisjet e KOSTT me qëllim të parandalimit të lëndimeve dhe ruajtjes së shëndetit.

Në përkushtimin e vazhdueshëm për ngritjen e cilësisë së punës dhe me qëllim të zbatimit efikas, përbushjes së kërkesave ligjore, rregullatore dhe palëve të interesit si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve të punës, KOSTT ka ndërtuar dhe mirëmban Sistemin e Integruar të Menaxhimit (SIM), duke përfshirë Standardin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 si dhe Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë OHSAS 18001:2007.

Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë zotohen për unifikimin e tregut të energjisë dhe pjesëmarrjen e KOSTT në APEX



Në takim i cili u mbajt më 3 tetor 2017 në Tiranë në mes të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Valdrin Llluka dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës së Shqipërisë z.Damian Gjicknuri, u diskutua rreth procesit të krijimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike në mes të dyja

vendeve, krijimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX) si dhe sfidave që po e pengojnë vënien në operim të linjës së re interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Në kuadër të takimit, ku pjesë e delegacionit ishte edhe u.d Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu, Ministrat Llluka dhe Gjicknuri u dakorduan që të intensifikohen angazhimet e grupeve punuese drejt unifikimit të tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri dhe emërimin e koordinatorëve të nivelit politik në kuadër të këtij procesi.


Në kuadër të takimit, gjithashtu u konfirmua pjesëmarrja e KOSTT si aksionare në bursën shqiptare të energjisë (APEX), që është në proces të krijimit si dhe të dy ministrat u dakorduan që të harmonizohen veprimet në drejtim të zhbllokimit të procesit për vënien në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, projekt i implementuar në bashkëfinancim me Qeverinë Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW).

Inaugurohet Asociacioni i Gruas në Sektorin e Energjisë në Kosovë

Më datë 27 Qershor 2017, në një ceremoni rasti u bë inaugurimi i Asociacionit të Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë- AGSEK, projekt ky i themeluar nga anëtarët e AGSEK përfshirë dhe KOSTT, me përkrahje të USAID (RePower) dhe që ka për qëllim fuqizimin e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në fund të ceremonisë, u shpërndanë certifikatat nga e ngarkuara me punë në Ambasadën e SHBA, znj. Colleen Hyland për udhëheqës të mCircle dhe anëtarët themelues të AGSEK.





Menaxhmenti i lartë i KOSTT priti në takim zv.Ambasadorin e RF të Gjermanisë Jan Axel Voss dhe delegacionin nga KfW



Menaxhmenti i lartë i KOSTT në krye me ud.Kryeshefin Ekzekutiv z.Kadri Kadriu, me 30 gusht 2017 pritën në vizitë delegacionin e lartë nga Ambasada Gjermane, udhëhequr nga zv.Ambasadori i Republikës Gjermane në Kosovë z.Jan Axel Voss dhe drejtorin e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për Kosovë dhe Maqedoni z. René Eschemann.

Në fokus të kësaj vizite ishte njoftimi i delegacionit gjerman me gjendjen aktuale të Sistemit Transmetues të Kosovës, ndikimin e investimeve të vazhdueshme në zhvillimin e rrjetit të transmetimit, me theks të posaçëm atyre të Qeverisë Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), ku kontributi i tyre në investime të përgjithshme është 35.19% si dhe në ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit.

“Zhvillimi i sektorit të energjisë në Kosovë është një nga prioritetet e Ambasadës Gjermane”, theksoi zv.Ambasadori Gjerman z.Voss, dhe me këtë rast shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të frytshëm edhe në të ardhmen. Në takim, gjithashtu u diskutua në lidhje me sfidat me të cilat po përballon KOSTT si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçje

me ENTSO-E, sfidat aktuale të hapjes së tregut të energjisë në Kosovë që ka filluar këtë vit, si dhe mosfunktionalizimit të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, investim ky i realizuar në bashkëfinansim me KfW. Delegacioni gjerman, gjithashtu u njoftua edhe me progresin në integrimin e tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri si dhe progresit në themelimin e bursës shqiptare të energjisë (APEX).

z.Kadriu, me këtë rast falënderoi Qeverinë Gjermane për përkrahjen e vazhdueshme në zhvillimin e Sistemit Transmetues të Kosovës dhe shprehu gatishmërinë e KOSTT për të vazhduar me implementimin e projekteve të planifikuara të radhës, që përkrahjen financiarisht nga Qeveria Gjermane, në mbështetje të rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe të zhvillimit ekonomik të vendit.



Integrimi i Burimeve të Ripërtëritshme në Rrjetin Transmetues dhe menaxhimi i Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme



Gazmend Kabashi



Shyqeri Morina

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) paraqesin një burim të rëndësishëm të energjisë me të cilin disponon Kosova, me një potencial ende të pashfrytëzuar sa duhet. Shfrytëzimi i këtyre burimeve për prodhimin e energjisë përbën objektiv afatgjatë për realizimin e qëllimeve të politikës energjetike të vendit siç janë: mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtja e mjedisit. Një rol të rëndësishëm për promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë luajnë edhe Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe ai i Shpërndarjes. Këta dy Operator janë të ngarkuar me ligj që t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, sipas standardeve të specifikuara në Kodin e Rrjetit.

Investimet e realizuara në infrastrukturën e transmetimit në dekadën e fundit kanë rezultuar me një rrjet transmetues efikas, të besueshëm dhe mjaftë të sigurt. Ky zhvillim ka krijuar kushte të favorshme për përkrahjen e integrimit të burimeve të ripërtëritshme në rrjetin transmetues. Duke konsideruar kapacitetet që ka Kosova në burimet e ripërtëritshme, kyçja e gjeneratorëve të tillë pritet kryesisht të ndodhë në rrjetin 110 kV i cili është mjaftë mirë i zhvilluar dhe i shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

KOSTT ka zhvilluar procedurë mjaftë efikase për shqyrtimin e Aplikacioneve për kyçje në Rrjetin Transmetues, duke bërë të mundur eviti-


min e vonësive procedurale të cilat ndikojnë në kohën e realizimit të projektit. Deri më tani edhe përkundër faktit që BRE-të përkrahen me tarifa nxitëse mjaftë atraktive, në Rrjetin Transmetues është kyçur vetëm një Hidrocentral me kapacitet 35 MW (HC Kelkos) në rrjetin 110 kV. Në proces të ndërtimit është edhe parku energjetik me erë "Kitka" me kapacitet të instaluar 34.5 MW, i cili do të lidhët në NS Berivojce përmes linjës 110 kV me gjatësi 16 km. Në proces të nënshkrimit të Marrëveshjeve së Kyçjes janë edhe dy projekte të erës dhe një HC:

- Parku energjetik me erë "Selaci 1, 2 dhe 3" me kapacitet të instaluar 105MW
- Parku energjetik me erë "Koznica" me kapacitet të instaluar 34.5MW
- HC Lepenci me kapacitet 9.92 MW

Gjithashtu viteve të fundit vërehet një interesim i madh i investitorëve për burimet solare (Fotovoltaike) të cilët janë të interesuar të zhvillojnë projekte të tilla të kapacitetit të madh që do të kyçen në rrjetin transmetues. Për këtë arsye KOSTT ka përgatitur Kodin për Stacionet Gjeneruese të Energjisë Solare, i cili përcakton kriteret teknike që duhet të plotësohen nga aplikuesi i këtij lloji të BRE-së.

Rrjeti transmetues ka kapacitetet të mjaftueshme për integrimin e burimeve të ripërtëritshme të të gjitha llojeve, mirëpo problemi i vetëm për Operatorin e Sistemit mbetet ngritja e nevojave për rezervat rregulluese të sistemit, me theks të veçantë rezerva sekondare dhe terciare e shpejt. Kjo rritje e nevojave për fuqi rregulluese shkaktohet për shkak të fuqisë variabile që prodhohet nga gjenerimi me erë dhe ai solar si dhe nga problemet në parashikimin e prodhimit nga BRE-te.

Kjo problematikë do të evitohet përmes integrimit të tregjeve të vogla në treg të integruar rajonal, ku qasja në shërbimet ndihmëse do të jetë e lehtë, ndërsa edhe niveli i rezervave rreg-



ulluese reduktohet nga një integrim i tillë. Për stimulimin e shfrytëzimit të BRE-ve, në Kosovë janë vendosur masa nxitëse, me qëllim plotësimin e caqeve të energjisë nga BRE-të të planifikuara për vitin 2020, si kërkesë e Direktivës 2009/28/KE, transpozimi dhe implementimi i të cilës bëhet nën monitorimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në kuadër të masave për nxitjen e shfrytëzimit të BRE-ve, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka miratuar Rregullën për Skemën Mbështetëse, e cila përcakton parimet e mbështetjes së Gjeneratorëve të BRE-ve. Sipas kësaj rregulle, Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar kanë të drejtë të

shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike tek Operatori i Tregut në KOSTT, përmes Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë të lidhur me KOSTT-in.

Me qëllim të mbështetjes së Gjeneratorëve të BRE-ve është themeluar Fondi për Energjinë e Ripërtërishme, i menaxhuar nga Operatori i Tregut. Nëpërmjet këtij fondi, Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse ose nën Kornizën e Rregulluar paguhet për prodhimin e tyre, ndërsa furnizuesit paguajnë për energjinë e ripërtërishme në proporcion me pjesëmarrjen e konsumit të tyre individual në konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë.

KOSTT nënshkruan Marrëveshje me Gjeneratorët e Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme

Në përputhje me Ligjin e Energjisë Elektrike, Rregullën për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë i miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe udhëzimin e ZRRE që deri me datën 31.12.2017 prodhuesit BRE që kanë marrëveshje me KESCO duhet të shkëpusin marrëveshjen me KESCO dhe të nënshkruajnë marrëveshje me Operatorin e Tregut, në muajin tetor 2017 KOSTT ka filluar procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE) me të gjithë Gjeneratorët e BRE-ve.

Janë nënshkruar marrëveshjet me prodhuesit BRE në operim: EUROKOS, ONIX, BREZOVICA, HYDROLINE

Është në procesin e finalizimit edhe nënshkrimi i marrëveshjes me prodhuesit BRE BELAJA dhe DEÇANI

KOSTT merr pjesë në Seancën Dëgjimore për Shqyrtimin e Dytë Periodik Rregullativ



Nën organizimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), me 19 shtator 2017 në Prishtinë u mbajt seanca dëgjimore për Shqyrtimin e Dytë Periodik Rregullativ (SHPRR 2), ku para të pranishmëve u prezantuan kërkesat për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM/MAR) nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes-KEDS.

Pas fjalës hyrëse të u.d. Kryesuesit të Bordit të ZRRë z.Arsm Janova i cili foli për qëllimin e shqyrtimeve shumëvjeçare të HLM dhe fjalës së udhëheqësit të Departmentit të Tarifave dhe Çmimeve në ZRRë z.Ymer Fejzullahu i cili njoftoi të pranishmit mbi procesin dhe metodologjitë mbi të cilat mbështetet aprovimi i HLM-ve, para të pranishmëve mbajti prezentim u.d. Kryeshefi Ekzekutiv i


KOSTT z.Kadri Kadriu.

z.Kadriu prezantoi të arriturat dhe performancën e KOSTT tani në përmbyllje të Periudhës aktuale 5 vjeçare rregullative, si dhe propozimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e ardhshme të mbështetura me arsyeshmërinë si për investimet e planifikuara ka-

pitale ashtu dhe për kostot operative, gjithnjë duke pasur parasysh rolin kyç të KOSTT në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës.

Procesi i SHPRR 2 është iniciuar nga ZRRë më 15 maj 2017, ndërsa vendimi i Bordit të ZRRë për MAR pritet të merret deri me 15 mars 2018.





Drejtori i Zyrës Rajonale Evropiane të Departmentit të SHBA për Energji vizitoi KOSTT-in

ud.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu me bashkëpunëtorë, me 8 shtator 2017 priti në takim Drejtorin e Zyrës Rajonale Evropiane të Departmentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Energji z.Dan Milstein i cili ishte i shoqëruar edhe nga zyrtarë të Ambasadës Amerikane në Kosovë dhe të Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë.

Menaxhmenti i lartë i KOSTT e njoftuan z.Milstein lidhur me rolin qenësor që mban KOSTT në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës në mbështetje të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe investimet e vazhdueshme që po realizohen në infrastrukturën transmetuese të Kosovës në përkrahje të zhvillimit të tregut të liberalizuar të energjisë elektrike në Kosovë.

Në takim gjithashtu u diskutua edhe rreth sfidave me të cilat po përballlet KOSTT në



proceset e integrimi në mekanizmat rajonal dhe evropian si dhe rreth progresit të bashkimit të tregut të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri dhe pjesëmarrjes së Kosovës në bursën shqiptare të energjisë (APEX), këto të fundit projekte për të cilat KOSTT është përfitues i asistencës teknike të USAID-it.

Me këtë rast, z.Kadriu falënderoi z.Milstein për mbështetjen e vazhdueshme që shteti amerikan është duke i dhënë KOSTT-it përmes USAID dhe njëherit kërkoi përkrahjen e

shtetit amerikan për tejkalimin e sfidave në drejtim të fillimit të implementimit të Marrëveshjes për Kyçe me ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity), si një element qenësor që mundëson ushtrimin e funksionit të plotë të KOSTT si Operator i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve nga procesi Berlinit i njohur si Iniciativa e Ballkanit Perëndimor 6 (WB6 Initiative) dhe zbatimin e plotë të reformave dhe integrimin në tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike.

Delegacioni nga institucionet amerikane gjithashtu vizituan Qendrën Nacionale Dispečerike në KOSTT, ku u njoftuan rreth funksionimit të Sistemit Transmetues të Kosovës dhe pengesave për funksionalizimin e linjës së re interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.



Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT



Fëllënëza Xhelili Fiqi


KOSTT si monopol natyral është kompani e rregulluar dhe një nga fushat e rregullimit është ai i të hyrave të lejuara maksimale.

Ky rregullim mbulohet nga **legjislacioni primar**, respektivisht: Ligji për Energjinë (05/L-081), Ligji për Energjinë Elektrike (05/L-085), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (05-L-084), si dhe **legjislacioni sekondar**, respektivisht: Rregulla për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT-së, Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe tregut si dhe taksave të kyçjes, Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit_SHST, Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit si dhe Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut.

Siç është përcaktuar nga ligjet e lartpërmendura, Zyra e Rregullatorit të Energjisë – ZRrE është organi i cili bën rregullimin dhe mbikëqyrjen e kompanive energjetike në Kosovë, dhe si e tillë rregullon të hyrat maksimale të lejuara, të cilat KOSTT i mbledhë çdo vit përmes tarifave për shërbimet e transmetimit dhe shërbimet tjera.

Forma e cila aplikohet për rregullimin e të hyrave të KOSTT është forma “tavan”, kurse vetë rregullimi përmban dy procese: Shqyrtimin Periodik Pesëvjeçarë dhe Përshtatjet e Rregullta Vjetore. Gjatë shqyrtimit periodik përcaktohen të hyrat maksimale të lejuara për pesë vite, përmes përcaktimit të parametrave për elementet e të hyrave maksimale të cilat si makrostrukturë mund t’i shohim në figurën e paraqitur më poshtë.


caktimit të parametrave për elementet e të hyrave maksimale të cilat si makrostrukturë mund t’i shohim në figurën e paraqitur më poshtë.




Procesi pesëvjeçarë i shqyrtimit periodik përfundon me vendimin e Bordit të ZRrE-së për të hyrat maksimale të lejuara për KOSTT për pesë vite.

Më tutje gjatë periudhës së përcaktuar rregullative, çdo vit zhvillohet procesi i përshtatjeve të rregullta përgjatë të cilit bëhet përshtatja e të hyrave dhe shpenzimeve të KOSTT me qëllim që: t’iu përmbahet parametrave të përcaktuar gjatë shqyrtimit periodik, t’i adaptohet ndryshimeve nga ngjarjet e paplanifikuara, të bëhet përshtatja sipas rrjedhave të energjisë etj.

Si përfundim i këtij procesi është llogaritja e tarifave vjetore për shërbimet e transmetimit dhe shërbimet tjera nga KOSTT dhe aprovimi i tyre nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.



KOSTT nënshkruan marrëveshjen e parë me kompani vendore për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre)



Harta e rrjetit të fibrave optik

Që nga viti 2004, paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi prej 1109.38 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë, brenda gypave në bërthamën e të cilëve janë të vendosur nga 24 apo 48 fije optike.

Në përputhje me këtë, KOSTT sh.a nënshkroi marrëveshjen e parë për ofrimin e shfrytëzimit me qera të rrjetës së fibrave optik (dark fibër/ të pa-ndriçuar), me tre operatorë të licencuar të shërbimeve telekomunikuese, përfaqësuar nga Fiberlink sh.p.k.

Përmes kësaj marrëveshje, e cila është lidhur në përputhje me nenin 5.2 dhe 5.3 të Rregullores për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/ fibër optike) dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, KOSTT sh.a ofron shërbimin e linjave me qira (fibra optik të pa-ndriçuar), në kohëzgjatje prej 3 vitesh për tri kompani vendore të licencuara për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese: "Vista" sh.p.k.

Suharekë, "Fiberlink" sh.p.k. Gjakovë dhe "Ace Waves" Prizren. Shërbimi i Fibrave të pa-ndriçuar u mundëson operatorëve të lidhin teknologjitë e tyre përkatëse të transmetimit optik me fibrat e pashfrytëzuara të rrjetit të KOSTT-it, për të ofruar shërbimet e veta të transmetimit në relacionin Gjakovë - Prizren - Suharekë.

Kjo është marrëveshja e parë përmes së cilës KOSTT ofron shërbim të linjave me qira të fibrave optik, iniciativë e cila është mbështetur dhe inkurajuar nga Banka Botërore.

Rrjeti i fibrave optik që posedon KOSTT përbushë kërkesat funksionale dhe operacionale për komunikime me zë dhe me të dhëna, për të mundësuar realizimin e bisedave telefonike dhe funksionimin e nënsistemeve si: SCADA/EMS, Matjet e Tensionit të Lartë, Mbrojtje nga distanca, rrjeti LAN/WAN dhe për komunikime inter OST (Operator i Sistemit të Transmisionit). Ky rrjet mjaft i avancuar është i aftë të ofroj shërbime komunikuese dhe të informacionit në qytetet dhe vendbanimet kryesore në gjithë territorin e Kosovës.

Në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe Rregullores për Autorizimet e Përgjithëshme, KOSTT është i regjistruar në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), në Regjistrin e Ndërmarrjeve për ofrimin e rrjeteve dhe / ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas Rexhimit të Autorizimit të Përgjithëshëm.



Komiteti Nacional CIGRE Kosova anëtarësohet në Asociacionin Ndërkombëtar CIGRÉ, me seli në Paris

Me datë 26 Tetor 2017 në Prishtinë, Komiteti Nacional CIGRE Kosova bëri prezantimin e rezultateve të pranimit të Kosovës në Asociacionin ndërkombëtar për sistemet e mëdha elektrike, CIGRÉ (International Council on Large Electric Systems) me seli në Paris, si dhe në organizatën rajonale të CIGRÉ – SEERC. Me këtë, në mesin e Komiteteve Nacionale të CIGRE, Komiteti Nacional i Kosovës bëhet anëtar i 59-të.

CIGRÉ si institucion ndërkombëtar profesional me seli në Paris është themeluar në vitin 1921 dhe anëtarët e saj vijnë nga më shumë se 90 vende të ndryshme

të botës. Në përgjithësi, CIGRE numëron mbi 10000 anëtarë kolektivë apo individual nga e gjithë bota. CIGRE është e përkushtuar në zhvillimin e sektorit të furnizimit me energji elektrike duke përfshi aspektet teknike, ekonomike, mjedisore, organizative dhe rregullative të Sistemeve të Energjisë Elektrike. Ndërsa organizata rajonale e CIGRÉ – SEERC është forum i ekspertëve të energjisë elektrike në Evropën Juglindore e cila së bashku me Kosovën numëron gjithsej 15 anëtarë, përkatësisht Komitete Nacionale.



Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut



gut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a është njëri nga anëtarët kolektiv të Komitetit Nacional CIGRE Kosova dhe njëri nga mbështetësit më të mëdhej të kësaj organizate profesionale. Ekspertë të KOSTT sh.a kanë përcjellur në mënyrë të vazhdueshme punën e CIGRE ndër vite si dhe kanë prezenuar punime të tyre profesionale në konferencat e organizuara nga CIGRE në vitin 2007 dhe 2013.

KOSTT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit “Hasan Prishtina”



Në vazhden e partneriteteve që KOSTT ka lidhur me institucione vendore dhe ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e shkathësisë dhe zhvillimit profesional të të rinjve të Kosovës, që ata të jenë më të përgatitur për tregun e punës në të ardhmen, KOSTT ka nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit “Hasan Prishtina”.

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përkrahjen e


ngritjes së kapaciteteve profesionale për studentët e FIEK, duke i'u mundësuar atyre realizimin e praktikës profesionale në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës. Dekani i FIEK Prof. Asoc. Dr. Enver Hamiti falënderoi KOSTT-in për gatishmërinë për bashkëpunim dhe shprehu përkushtimin e institucionit që ai drejton për të zhvilluar kuadro profesionale me kualitet për të shërbyer në sektorin e energjisë në Kosovë.

Me këtë marrëveshje bashkëpunimi, studentët do të kenë mundësi që të realizojnë praktikën profesionale në kohëzgjatje prej së paku 120 orë pune dhe pas realizimit të suksesshëm të prezentimit publik para anëtarëve të komisionit profesional dhe akademik do të

akumulojnë 6 kredi ECTS.

Me këtë dëshmohet përkushtimi i KOSTT për të përmbytur zotimin e dhënë me nënshkrimin e Paktit Evropian të Rinisë në vitin 2016, projekt i lansuar nga CSR Europe (Bruksel), përmes Kosovo CSR Network në Kosovë nën Patronatin e Lartë të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe me mbështetje nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Përmes Paktit, palët nënshkruese zotohen që bashkërisht do të angazhohen për të krijuar partneritete me institucione arsimore për të krijuar mundësi të reja për punë praktike, trajnime, zanatësi dhe/ose punësim direkt për të rinjtë. Pjesë e këtij projekti janë edhe 28 shtete anëtare të BE.



Emërtimi i Pajisjeve të Rrjetit Transmetues



Ibrahim Gashi

Identiteti fitohet në dy mënyra, lind si i ri ose evoluon me kohën. Identiteti është elementi i parë i njohjes dhe përfaqësimit.

Më 2006 Elektrobartja dhe Dispečingu merr identitetin si KOSTT si proces evolutiv. Fal vullnetit, dëshirës dhe punës së palodhshme, KOSTT si

identitet i ri pak i njohur në fillim, tani pas 10 viteve është sinonim i Rrjetit Transmetues të Republikës së Kosovës dhe pikë referente për sektorin e energjisë në Kosovë në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për të afirmuar një identitet të ri duhet përkushtim p.sh kompania japoneze tani me përmasa globale Sony themelohet fill pas Luftës së Dytë Botërore. Për të afirmuar identitetin, agjentët e marketingut të shpërndarë në vende të ndryshme, kishin mision që të kërkonin në restorant "Ju lutem a ka mundësi një Sony" derisa të merret përgjigja nga kamarieri "Më falni bëni shaka, Sony është një pajisje elektronike" Rasti me Sony tregon se për të krijuar identitetin duhet vendosmëri, përkushtim dhe mbi të gjitha vullnet. KOSTT krahas afirmimit të identiteti ka zhvilluar edhe shumë kode, norma, politika etj. të cilat përveç rregullimit të funksioneve të KOSTT, përkrahin edhe afirmimin e identitetit kombëtar dhe ndërkombëtar. Emërtimi i pajisjeve të rrjetit transmetues është një nga elementet për identifikimin.

Dokumenti "Emërtimi i Pajisjeve të Rrjetit Transmetues" përcakton mënyrën dhe principin e përgjithshëm të rinumërimit apo numërimit të ri në linjat ajrore apo kabllorë; si dhe riemërtimin apo emërtimin e ri të nënstacioneve dhe pajisjeve të tensionit të lartë, të cilat janë asete të KOSTT-it në pajtueshmëri me Kodin e Rrjetit - Kodin Operativ.

Deri më tani, identifikimi i linjave ishte si vazhdimësi e numeracionit jugosllav dhe numrat ekzistues nuk përfaqësonin gjithë informacionin që duhej pas pavarësimit të Rrjetit Transmetues të Kosovës. Emërtimi i nënstacioneve nuk identifikohet gjithëherë edhe me lokacionin, kurse

emërtimi i pajisjeve nuk ishte unik. Nevoja për numërim dhe emërtim me përfaqësues për elementet e Rrjetit Transmetues shtohet edhe pas investimeve të hovshme gjatë 10 vjeçarit të parë në rrjetin transmetues dhe trendit për të vazhduar edhe në të ardhmen, duke ndërtuar linja dhe nënstacione të reja si dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese.

Sipas dokumentit, numërimi i ri i linjave përfaqëson përveç, nivelin e tensionit të linjës nga numërimi paraprak edhe llojin e linjës (ajrore, kabllorë, dyfishtë) dhe vjetërsinë (numri më i vogël linja me e vjetër) shikuar si Rrjet Transmetues i Republikës së Kosovës. Emërtimi i ri i nënstacioneve, përveç niveleve të tensionit, krijonë edhe lidhje gjeografike me vendndodhjen e nënstacionit. Kurse emërtimi i ri për pajisjet e tensionit të lartë, unifikon emërtimet dhe simbollet grafike sipas standardeve ndërkombëtare.

Që kalimi nga emërtimet ekzistuese në emërimet e reja të jete me i lehtë, dokumenti parasheh një fazë kalimtare për objektet dhe pajisjet ekzistuese të rrjetit transmetues dhe aplikim të menjëhershëm për linjat, nënstacionet apo pajisjet që ndërtohen/instalohen në të ardhmen.

Emërtimi i pajisjeve të rrjetit transmetues ofron informacion bazë për përdorimin, qasjen, sigurinë, komunikimin e palëve, etj. Për të përmbushur këtë, përveç emërtimit të drejtë, duhet të bëhet aplikimi dhe promovimi i emërtimit të ri kur komunikojmë dhe shkruajmë si dhe të informohen të gjitha palët që ndikohen.

Hapi i parë në zingjirin e masave parandaluese për një punë në mënyrë të sigurt, është identifikimi i saktë i lokacionit, linjës, stabilimentit apo pajisjeve të rrjetit transmetues. Kjo garantohet duke bërë shënimet e sakta dhe përdorimin e tyre.

Mos të harrojmë se pari identifikimi pastaj vepërimi!



Projekti për Asistencën në Ngritjen e Kapaciteteve të KOSTT-it

Me qëllim të mbështetjes së integritimit të KOSTT në mekanizmat rajonal dhe evropian, si dhe anëtarësimin të plotë në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike (ENTSO-E), filloi projekti për asistencë në ngritjen e kapaciteteve në gusht të vitit 2016. Projekti zbatohet nga ekspertë nga tri kompani që formojnë një konsorcium: Elia Grid International (EGI), Pöyry Management Consulting (PMC) dhe Ernst & Young (EY).

Me qëllim që të përfitojë plotësisht nga një sistem i ndërlidhur me Sistemin Evropian Kontinental, KOSTT-i dëshiron të bëhet anëtar me të drejta të plota i ENTSO-E, si Operator i Pavarur i Sistemit, dhe në këtë mënyrë të operojë sistemin dhe tregun në përputhje të plotë me udhëzuesit, rregullat dhe kodin e ENTSO-E. Për të arritur këtë qëllim, një Katalog i Masave (KM) është zhvilluar së bashku me ENTSO-E. Në KM janë përpiluar të gjitha masat që duhet të ndërmerren nga KOSTT-i për të qenë në përputhje me udhëzuesit e ENTSO-E.

Konsorciumi mbështet KOSTT-in në ngritjen e kapaciteteve të nevojshme korporative, duke forcuar aftësitë funksionale dhe teknike dhe duke qenë në përputhje të plotë me udhëzuesit e ENTSO-E për t'u bërë anëtar me të drejta të plota. Projekti është strukturuar në pesë nivele të

punës, të quajtura “Detyrat”:

Detyra 1–Operimi i Sistemitka të bëjë me mbështetjen për KOSTT-in në zbatimin e politikave të ENTSO-E, duke përfshirë një analizë të nevojave për trajnim për departamentin e operimit të sistemit dhe përgatitjen e procedurave operacionale; Detyra

2–Operimi i Tregutka të bëjë me ndihmën dhe mbështetjen për Operatorin e Tregut në zbatimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës;

Detyra 3–Operimi si Bllok Kontrolli dhe Anëtarësia në ENTSO-Eka të bëjë me ndihmën për KOSTT-in në zbatimin e standardeve dhe procedurave të kërkuara teknike të ENTSO-E, me theks të veçantë në përafrimin me kërkesat e Kodeve të Rrjetit Evropian;

Detyra 4–Llogaritja e Tarifëska të bëjë me ofrimin e këshillave për KOSTT-in në lidhje me metodologjitë e llogaritjes së tarifave të rrjetit;

Detyra5–Projektimi Organizativka të bëjë me kryerjen e një rishikimi të nivelit të lartë të strukturës ekzistuese operative të KOSTT-it dhe propozimin e një strukture që përputhet me kërkesat e dhëna nga udhëzuesit dhe kodet e ENTSO-E për operimin e tregut dhe sistemit.

Cross-border and national balancing	
Legal possibility for transmission system operator to acquire balancing services from all operators in the national and in perspective of a regional market under competitive conditions	
Adoption of a market-based balancing model allowing for the non-discriminatory cross-border exchange of balancing services	
Establishment of a functioning national balancing market based on above model (Law on Electricity, Article 22, Comma 8)	

	Policy 1		Policy 2		Policy 3		Policy 4	Policy 5	Policy 8
1a	5c	10a	19b	22	34	39a	49	59	60
1b	5f	10b	19c	23	35	39b	50	59	60
1c	5g	10c	19d	24	36	40	51	59	60
2a	6	11a	20	25	37	41	52	59	60
2b	7a	11b	20a	26	38	42	53	59	60
2c	7b	11c	20b	27		43	54	59	60
2d	8	11d	20c	28		44a	55	59	60
2e	9	12	21	29		44b	56	59	60
3a		13		30		44c	57	59	60
3b		14		31		44d		59	60
4		15		32		44e		59	60
5a		16		33a		45		59	60
5b		17		33b		46		59	60
5c		18		33c		47		59	60
5d		19a		33d		48		59	60